



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Propozim-amandamentet për LNP-në

Për:	z.Alban Çollaku –kryesues i grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për ndërmarrjet Publike
Nga:	Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së
Kopje:	Kryetarët e Komunave
Data :	22 shtator 2011
Subjekti :	<u>Propozimet e AKK-së për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike</u>

I nderuar z.Çollaku,

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), paraqet rekomandimet kryesore të cilat kanë rezultuar nga takimet që AKK-ja i ka mbajtur me mekanizmat e saj .

Si në vijim:

- Neni 3 i LNP-se, pika 3.4** hiqet ne tërësi- (Arsyetim: Shumica e ndërmarrjeve komunale jane thelemuar nga komunat, menaxhuar dhe shumica e aseteve jane te komunave).
Arsyetim: Kjo pamundëson komunat që të kthejnë pronat e veta, të cilat i kanë pronë të tyre dhe ndërmarrjet të cilat vet i kanë themeluar, kanë menaxhuar dhe i kanë asetet e veta.)
- Neni 5, pika 5.2** e Ligjit në fuqi riformulohet sin ë vijim : Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar I emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal.Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. ÇdoKomision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar. **Komisioni Komunal i akcionereve e cakton kryesuesin. Anetaret e komisionit te Akcionareve duhet te kompenzohen. Pagesa per kompenzim behet nga buxhetet komunale.**

Arsyetim: Komisioni Komunal i Akcionereve duhet të kompenzohet, për të qenë funksional dhe frytdhënës, pasi praktikat e deritanishme kanë treguar se këto komisione nuk janë treguar funksionale dhe skanë treguar suksese.

3. **Neni 11**, pikat 11.1, 11.2, e Ligjit në fuqi riformulohet si në vijim :

11.1 Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo ndërmarrje e re publike mund të themelohet :

- a) Ndërmarrje Publike Qendrore me vendim të qeverisë;
- b) Ndërmarrje Publike Lokale me vendim të komunes;

11.2. Komunat mund të themelojnë NPL nga fushat e parapara me LVL-në në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe që përmbushin edhe kriteret e përcaktuara më poshtë:

- a) Nevoja për themelimin e NPL-së ;
- b) Plani i biznesit për ofrimin e shërbimeve publike komunale ;
- c) Qëndrueshmëria financiare e NPL-së ;

11.3 Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe në ligjin e sipër cekur, ndërmarrja e re publike do të jetë Ndërmarrje Publike Qendrore dhe Ndërmarrje Publike Lokale.

Arsyetim: Në kundërshtim me planin e Ahtisarit, Ligji i NP eliminon pushtet të plotë dhe ekskluziv të Komunës për të ofruar dhe mbajtur shërbimet në komunat e tyre.

Projektigji aktual i NP ka krijuar një sistem jo funksional, dhe në fakt e pengon ligjërisht komunat nga zbatimi i alternativave të realizueshme.

4. **Në neni 15, paragrafi 15.1** i ligjit në fuqi, riformulohet si në vijim:

15.1 Bordi i Drejtorëve të një NP Qendrore do të përbëhet nga pesë (5) ose shtatë (7) drejtorë. Të gjithë drejtorët, përveç njërit, do të zgjidhen nga Qeveria, **(perjashtimisht të NP e uhit, bordi menaxhues duhet të përbehet 50 % nga komunat dhe 50% nga qeveria (si rezultat i marrëveshjes me donator dhe me Task Forcës së ujit në kuader të zyrës së Kryeministrit)** kurse një dhe secili drejtor i zgjedhur në këtë mënyrë shërben me mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve të bordit të drejtorëve të një NP Qendrore, Qeveria mund të zgjedhë vetëm personat të cilët i janë rekomanduar Qeverisë nga Komisioni përkatës Rekomandues i themeluar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Qeveria duhet të sigurojë që së paku dy (2) drejtorë të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 të këtij ligji dhe një nga ta të jete i rekomanduar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Arsyetim: Marrëveshja është arritur mes kryetarëve të komunave, donatorëve dhe task Forcës së ujit, si zgjidhje më adekuate ka qenë dakordimi që në Bordet menaxhuese të ndërmarrjeve të Ujit të jenë 50 % nga niveli qendror dhe 50 % niveli lokal, si zgjidhje më e pranueshme, pastaj komunat do të nënshkruajnë marrëveshjet të cilat do të ndikojnë i

në përmirsim të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit si në rritje të inkasimit, pasi komunat do të përdorin mekanizmat e kushtëzimit.

5. **Lista e 2** -Ndërmarrjet Publike Lokale në Projekt Ligjin të riformulohet si në vijim: Stacionet e Autobusëve(shtohet Klina, Skenderaj, Kamenicë, Lipjan, Novo Berda) : Duhet të futen në Listën 2, pra të kalojnë në Ndërmarrjet Publike Lokale.

Arsyetim: Stacionet e Autobusëve janë pothuajse në çdo komunë, kjo krijon lidhje mes komunës dhe qytetarëve dhe shërbimet iu ofrohen me lehtë qytetarëve, kostoja është me e lirë, menaxhimi më i lehtë. Po ashtu mbesin 20 NP Lokale të cilat janë paraqitur në Projektligj dhe shtohet edhe një NPL Tregu Prishtinë.

Mbesim me shpresë se rekomandimet do të shqyrtohen nga grupi punues dhe do të pranohen sit ë tilla, pasi që janë kërkesa vazhdueshme të komunave për plotësim-ndryshimin e ligjit në fjalë.

**Me respekt,
Sazan Ibrahim
Drejtor Ekzekutiv**